



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:069957

Datë: 24.02.2021

Numri i dokumentit: 01597798

C.nr.987/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- gjyqtari Habib Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit B. M. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av.Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurës Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Armend Hysa në çështjen juridike kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, pas mbajtjes së seancës gjyqësore të datës 24 shkurt 2021, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, të njëjtën ditë mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e themeltë kërkesëpadia e paditësit B. M. nga Ferizaj, ashtu që **DETYROHET** e paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 111 dite pune, t'i paguaj paditësit nga 2 euro për çdo ditë, shumën prej 222.00 € (dyqind e njëzetë e dy euro) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 99.00 € (nëntëdhjetë e nëntë euro) të gjitha brenda afatit prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim do të ketë karakterin e titullit ekzekutiv dhe mund të përmbarohet menjëherë.

II. REFUZOHET kërkesa e paditësit për shpenzime të procedurës, përtej shumës së aprovuar në lartësi prej 101 € (njëqind e një euro euro) si e pa bazuar.

A r s y e t i m i

Paditësi B. M., përmes të autorizuarit të saj av.Leutrim Ademi, më datë 16 qershor 2020 në këtë gjykatë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, që në emër të pagës jubilarë të ushqimit ta kompensoj paditësin pas administrimit të provave. Paditësi ka pretenduar se e drejta e saj për kompensim

të shpenzimeve të ushqimit bazohet në Kontratën Kolektive të datës 18 prill 2017 të nënshkruar mes MASHT-it dhe SBASHK-ut.

Lidhur me këtë, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor më 24 shkurt 2021, në të cilën i autorizuari i paditësit ka propozuar që të ndryshohet kërkesëpadia, pasi që sipas tij gabimisht është kërkuar kjo kërkesë, pasi që është dashur të jetë kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit. Përfaqësuesi i të paditurës nuk e ka kundërshtuar ndryshimin e kërkesëpadiës së paditësit.

Gjykata me aktvendim procedural ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadiës së paditësit, duke e konsideruar kërkesën e paditësit si kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit. Gjykata me rastin e vendosjes është bazuar në dispozitën e nenit 257 par.1 të LPK-së.

Pas kësaj, i autorizuari i paditësi ka mbetur pranë kërkesëpadiës së precizuar, ashtu që ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve të ushqimit për 111 ditë pune, ta kompensoj në lartësi prej 222.00 €, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës në lartësi prej 200 €, dhe atë për përpilim të padisë 78 euro, për pjesëmarrje në seancë gjyqësore 101 € dhe për taksë gjyqësore 21 €.

Përfaqësuesi i të paditurës, e ka kundërshtuar padinë e paditëses, duke theksuar se Këshilli Drejtues i USHAF, e ka refuzuar e sindikatës për kompensimin e shujtave ditore për shkak se në buxhetin e universitetit nuk ka pasur mjete të destinuara për implementimin e kësaj kërkesë, andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pa bazuar dhe ta vërtetojë vendimin e këshillit drejtues numër 766/20 të datës 02 mars 2020. Ka shtuar se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, ashtu që nuk janë kontestuese as ditët e pranisë në punës.

Gjykata, pa bërë administrimin e provave, ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e detyruar të paditurën që ta kompensojë paditësin në lartësi prej 670 euro për 335 ditë të pranisë në punë tek e paditura dhe atë bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të nënshkruar mes MASHT-it në njërin anë dhe SBASHK-ut në anën tjetër më 18 prill 2017, e sipas asaj dispozite është përcaktuar *të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë.*

Lidhur me vendimin mbi kamatën ligjore, gjykata vendosur që të jetë 8 % duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit, deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket shmangies nga administrimi i provave, gjykata ka vlerësuar se faktet e pohuara nga pala e paditur në këtë rast, nuk ka nevojë që bëhet administrimi i provave për të vërtetuar faktet. Për më tepër ky vlerësim i gjykatës gjen mbështetje në dispozitën e nenit 321 par. 2 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton; *Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësorë.*

Në lidhje me pretendimin e të paditurës se nuk ka pasur mjete të ndara për këtë kategori, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë është tërësisht i pa justifikueshëm, ngase e paditura si institucion që menaxhon edhe mjete financiare sipas Kontratës Kolektive, ka qenë e obliguar që me kohë të planifikojë ndarjen buxhetore për këtë kategori në përgjithësi, dhe për paditësin në veçanti.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 125.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 € (sipas rregullores mbi tarifën e OAK-së në fuqi) kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21 €.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata e ka refuzuar kërkesën e paditësit për shpenzime të procedurës, përtej shumës së aprovuar, për shkak se një kërkesë e tillë nuk ka rezultuar të jetë e justifikuar dhe e bazuar, për faktin se paditësi lehtësisht ka mundur qysh në paraqitjen e padisë në gjykatë ta bëjë të qartë përcaktimin e kërkesës në lidhje me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, e që si rrjedhojë pastaj, me të pranuar përgjigjen në padi nga e paditura gjykata, do të mundej të merr aktgjykim edhe pa caktimin e seancës gjyqësore, sepse jo domosdoshmërisht është e thënë që për çdo kontest të hapet seancë gjyqësore, sepse përcaktimi ligjor i marrjes së aktgjykimeve jashtë seancave gjyqësore, të parapara sipas LPK-së, do të konsiderohej i pa kuptimtë.

Paditësi me rastin e përpilimit të padisë në mënyrën siç e ka dorëzuar në gjykatë, konsiderohet se i ka kontribuar vet që të hapet seancë gjyqësore, që bazuar në natyrën e kontestit nuk ka qenë e nevojshme të për seancë gjyqësore. Andaj, gjykata me rastin e vendosjes lidhur me këtë pjesë të kërkesës për shpenzime të procedurës, është bazuar në dispozitën e nenit 453 par.1 të LPK-së, e cila dispozitë ka përcaktuar *Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të merre parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat.*

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.987/20, me datën 24 shkurt 2021

Gjyqtari
Habib Zeqiri

KESHILLA JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 (shtatë) dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.